

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje materiale pastrimi

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39831200-8 - Detergjentë

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **49 999 297**(*dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë*) **Lekë pa Tvsh.**

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **501 045** (*pesëqind e një mijë e dyzet pesë*) **Euro pa Tvsh.** (*Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 15.08.2024 është 99.79 lekë.*)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet çertifikata ISO e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshir në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata ISO e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Ligjit nr.27/2017 datë 17.03.2016 "Për menaxhimin e kimikateve", Ligjin nr.10216 datë 21.01.2010 "Për detergjentët". Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Kuadri ligjor që rregullon tregtimin dhe përdorimin e produkteve detergjentë i kushton një rëndësi parësore mbrojtjes së mjedisit për vetë natyrën e rrezikshmërisë që mbartin këto produkte objekt prokurimi. Ky certifikim ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Çertifikimi i operatorëve ekonomikë ofertues me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit garanton autoritetin kontraktor për sigurinë e trajtimit të produkteve detergjentë në të gjithë zinxhirin e furnizimit nga burimi i furnizimit deri në destinacionin e kërkuar.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet certifikata ISO e kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. është kërkuar kjo certifikate pasi ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë përfshirë gjithë aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorë ekonomik, të cilët do të ekzekutojnë këto kontrata furnizimi. Një OE i certifikuar sipas këtij standardi është në gjendje të:

- Krijojë kushtet më të mira të punës në gjithë organizatën e tij;
- Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre
- Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive
- Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune
- Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve

Të gjitha këto janë garanci se OE i shpallur fitues i cili është i certifikuar sipas këtij standardi ka kapacitetet e duhura për realizuar me sukses kontratat me AK-të. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.1.4 Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet çertifikata e akreditimit përkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr.667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që *bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"* i ndryshuar.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për Vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit

në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizat të lëshuara nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për përqendrimin e lëndëve tensioaktive në produktet objekt prokurimi detergjentë me nr.1 deri nr.5 sipas tabelës së Shtojcës 6, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të kërkuara në zbatim të bazës ligjore në fuqi për detergjentët (shiko tek argumentimi i kriterëve të pranimit kualifikimit).

Argumentimi: Në bazë të nenit të 79, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 8 të Ligjit nr.10216, datë 21.01.2010 “Për detergjentët”, , VKM nr.220 datë 28.3.2012 “Për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente”, nenit 12 të Ligjit nr.9779 datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve jo-ushqimore”, nenit 9 të Ligjit nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të;

- ❖ nenit 8 të Ligjit nr.10216, datë 21.1.2010 “Për detergjentët”, nenit 12 të Ligjit nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve jo-ushqimore”, i cili shprehet se *Autorizimi i laboratorëve dhe pranimit i*

testeve.....**1. Ministria pranon testet e kryera vetëm në laboratorë të akredituar.** **2. Ministria autorizon laboratorët, të cilët kryejnë testimet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Akreditimi i këtyre laboratorëve bazohet në standardin EN ISO/IEC 17025:2005 ose në kërkesat e praktikës më të mirë laboratorike. Metodat e testimit, për të cilat këta laboratorë akreditohen, janë metodat e listuara me vendim të Këshillit të Ministrave.** **3. Mbikëqyrja e laboratorëve të akredituar, të autorizuar nga ministria, kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.....**

❖ nenit 18 të Ligjit nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i cili shprehet se....*Organet e miratuara...1. Organi i miratuar kryen veprimtaritë sipas objektit të përcaktuar në vendimin e miratimit, si dhe veçanërisht: a) kryen objektivisht shqyrtimin/ekzaminimin teknik me profesionalitet dhe mban parasysh nivelin e shkencës dhe të teknologjisë në kohën e kryerjes së ekzaminimit; b) lëshon certifikata ose harton raporte për testimet dhe vlerësimin e konformitetit, bazuar në ekzaminimin teknik, duke ndjekur procedurat e vlerësimit të konformitetit të përshkruara në rregullat teknike/rregullat e sigurisë në shërbim.....*

- Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin fletë analiza zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me detergjentë dhe materiale pastrimi të cilat do të përdoren në objekte publike, shkollore dhe parashkollore, duhet të jenë konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se provueshmëria e efikasitetit të këtyre produkteve ndikon drejtpërdrejt në masat e nevojshme të higjienizimit që duhen ndërmarrë për parandalimin e e shpërndarjes së viruseve dhe mikrobeve, pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara do të përbënte rrezik evident për objektet publike dhe arsimore.
- Arsyeja se përse autoriteti kontraktor kërkon fletë analizë të lëshuar nga ente certifikuese të autorizuar, është natyra e veprimit dhe destinacioni i përdorimit të këtij produkti. Këto produkte janë parashikuar nga autoriteti kontraktor që të përdoren në ambjentet e brendshme të objekteve parashkollore dhe shkollore të cilat frekuentohen nga fëmijë të moshës 5 vjeç deri në 18 vjeç, prandaj rëndësia e garantimit të këtij produkti për efikasitetin e tij dhe cilësinë e kërkuar brenda parametrave të kërkuara nga legjislacioni në fuqi e bën të domosdoshme garantimin e sigurisë së këtij produkti nga ente certifikuese të akredituara.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin fletë analiza të produkteve detergjentë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me detergjentë dhe materiale pastrimi të cilat do të përdoren në objekte publike, shkollore dhe parashkollore, duhet të jenë konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se provueshmëria e efikasitetit të këtyre produkteve ndikon drejtpërdrejt në masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për parandalimin e e shpërndarjes së viruseve dhe mikrobeve, pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara do të përbënte rrezik evident për objektet publike dhe arsimore.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatë/Deklaratë Konfirmimit CE ose raportet e testimi të lëshuara nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktet objekt prokurimi për të cilat janë kërkuar standarte teknike kombëtare ose ndërkombëtare sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së standarteve teknike të kërkuara.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 79, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 12 të Ligjit nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve jo-ushqimore”, nenit 9 të Ligjit nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të certifikimeve apo testeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me materiale të cilat do të përdoren në objekte publike, shkollore dhe parashkollore, duhet të jenë konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se provueshmëria e efikasitetit të këtyre produkteve ndikon drejtpërdrejt në masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për parandalimin e problematikave që ka mirëmbajtja dhe higjiena e godinave, pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara do të ndikonte drejtpërdrejt në mbarëvajtjen dhe efikasitetin e shërbimeve në objektet publike dhe arsimore.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues për produktet objekt prokurimi detergjentë me nr.1 deri nr.5 në tabelën e Shtojcës 6, duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it (shiko tek argumentimi i kriterëve të pranimit kualifikimit).

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM,nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se disa nga mallrat objekt të kësaj kontrate do të përdoren në objekte publike dhe arsimore, duhet të jenë konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që për garantimin e cilësisë së mallit nga vetë natyra e përdorimit është shumë e rëndësishme përmbushja e specifikimeve teknike pasi do të përdoren në ambjente që frekuentohen nga fëmijë të moshës 5 vjeç deri 18 vjeç dhe në ambjentet ku zhvillohet aktiviteti mësimor.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues për produktin objekt prokurimi “Sapun i lëngshëm” (produkti me nr.1 në tabelën e Shtojcës 6), duhet të paraqesë raportin e testimin dermatologjik lëshuar nga laborator i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë, bazuar në kërkesat e pikës 3 të Tabelës nr.1 sipas Udhëzimit të Përbashkët nr.294 datë 06.05.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 79, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që për garantimin e cilësisë së mallit nga vetë natyra e përdorimit është shumë e rëndësishme përmeshja e specifikimeve teknike pasi do të përdoren në ambiente që frekuentohen nga fëmijë të moshës 5 vjeç deri 18 vjeç dhe në ambientet ku zhvillohet aktiviteti mësimor. Patch testi dermatologjik është një metodë testimi që përdoret përgjithësisht për hetimin dhe verifikimin e substancave që shkaktojnë dermatitin alergjik të kontaktit. Kjo metodë testimi përfshin aplikimin e alergjenëve të holluar siç duhet në lëkurë për një kohë të caktuar. Reagimet pozitive prodhojnë një copë dermatiti që shfaqet si një zonë e kuqe dhe ndoshta e ngritur, vezikulare apo edhe me flluska në vendin e aplikimit të alergjenit ofendues duke përcaktuar dhe shkallën e mundësisë për alergjitë e mundshme që mund të shkaktohen.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose qira, të paktën 2 (dy) automjete ATP (automjetet e transportit të përzier). Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë dokumentacionin shoqëruar për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin, Taksën e Qarkullimit) të vlefshme, ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë si dhe dokumentacionin shoqëruar për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Taksën e Qarkullimit, Kolaudimin,) të vlefshme.

Shënim: Ky kriter (2.3.8) do të konsiderohet i përmeshur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur operatori ekonomik ofertues renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmeshur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e lëndës djegëse pellet për ngrohje në objekte të shpërndara në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, automjetet e mësipërme konsiderohen të domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objekteve në të cilat do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmeshjen me sukses të kontratës.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për produktet objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përket. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/ distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike”, për mallrat objekt prokurimi, sipas tabelës të paraqitur nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6. Oferta teknike duhet të plotësohet me saktësi nga ofertuesi për të gjithë artikujt e listës. Në plotësim të kësaj kërkesë dokumenti “Ofertë Teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i produkteve	Emërtimi kompanisë prodhuese.	Emërtimi i katalogut ose skedës teknike	Referenca në katalogje	Shënime (nëse gjykohet e nevojshme për sqarime nga ofertuesi)
				KOD i produktit ose nr. Faqes në katalog	

- Emërtimi dhe renditja e produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 6.
- Emërtimi i Katalogut ose skedës teknike të prodhuesit/distributorit të autorizuar. Referenca në katalogje, kodi produktit (*në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes*), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ose skedën teknike përkatëse për çdo produkt ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST.
- Në fushën “SHËNIM” operatori ekonomik ofertues mund të shkruajë sqarime të ndryshme në lidhje me produktet e ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe i shërben Autoritetit Kontraktor në identifikimin sa më të saktë të informacionit teknik dhënë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke sjellë lehtësi dhe shmangie konfuzioni në punën e Autoritetit Kontraktor për vlerësimin e ofertave. Kjo kërkesë lehtëson në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e operatorëve ekonomikë ofertues për të paraqitur produktin e saktë sipas kërkesave të DST, pasi në shumë katalogje teknike të prodhuesve/distributorëve të ndryshëm kemi konstatuar që pasqyrohen produkte me karakteristika dhe emërtime të ngjashme.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues i renditur i pari në vlerësim, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e dorëzimit të dokumentacionit fizik, nga jo më pak se një 1(një) kampion për mallrat objekt prokurimi, sipas listës së publikuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën nr.6.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.
- Mostra duhet të jetë për të gjithë artikujt e kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.488, datë 29.06.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.669 datë 28.09.2011, “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentet”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga rëndësia që ato kanë për shkak të funksionalitetit special të tyre. Në këtë rast paraqitja e mostrave është konsideruar nga autoriteti kontraktor si e nevojshme pasi verifikimi fizik i tyre është gjykuar i rëndësishëm për të vlerësuar detyrimet ligjore të ambalazhimit dhe etiketimit të produkteve, sigurinë gjatë furnizimit së produkteve dhe sigurinë ndaj përdoruesve të tyre.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë një deklaratë me shkrim që merr përsipër me mjetet e veta dhe me punonjësit e vet të realizojë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në kohë dhe në sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në të gjitha objektet shkollore nën administrim të autoritetit kontraktor në territorin e Bashkisë së Tiranës sipas planit të shpërndarjes i cili do t'i vihet në dispozicion nga autoriteti kontraktor ditën e lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion burimet njerëzore, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se disa nga disa nga mallrat objekt të kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e mallrave me rrezikshmëri për mjedisin, kjo deklaratë konsiderohet e rëndësishme pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objekteve në të cilat do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 “Për detergjentët”, VKM nr.220, datë 28.3.2012 “Për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente”, VKM nr.669 datë 28.09.2011, “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët”, Ligjit nr.9779 datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve jo-ushqimore”, nenit 9 të Ligjit nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave objekt të prokurimit. Produktet e kërkuara janë të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të autoritetit kontraktor. Këto produkte garantojnë marrjen e masave efektive për krijimin e kushteve optimale të higjienës në objektet publike dhe arsimore sipas detyrimeve të përcaktuara në legjisllacionin në fuqi. Karakteristikat teknike dhe përbërësit kimikë të produkteve janë kërkuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në bazën ligjore në fuqi për detergjentët dhe produktet jo-ushqimore. Standartet teknike të kërkuara janë konsultuar me bazën ligjore në fuqi ku është verifikuar përcaktimi teknik për çdo element në veçanti. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Parametrat e përcaktuar në treguesit respektivë janë vendosur në raport me kërkesat e AK për sigurimin e artikujve cilësorë si në këndvështrimin fiziko-kimik por edhe në këndvështrimin sasior që ka të bëjë me volumin, peshën specifike apo përmasat e tyre. Duke iu referuar nevojave specifike të objekteve arsimore në funksion të shërbimit të pastrimit cilësor, për të cilin shërbejnë këto materiale, nga gjithë shumëllojshmëria e artikujve të ngjashëm, të markava të ndryshme tregtare, që gjenden në treg, janë

përzgjedhur ata artikuj të cilët kanë karakteristika të njëjta edhe pse janë të markave tregtare të ndryshme por që në raport me çmimin dhe specififikimet përkatëse për secilin prej tyre, plotësojnë më së miri si nga ana cilësore por edhe nga ana sasiore këtë shërbim, i cili merr një rëndësi të veçantë përderisa është në funksion të objekteve arsimore si qendra rezidenciale për fëmijë të grupmoshave nga 5 vjeç deri në 18 vjeç.

Për sa i përket konfeksioneve të përcaktuara për secilin artikull, janë lënë hapësirat e nevojshme minimale dhe maksimale, referuar paketimeve që gjenden në treg, por duke patur gjithmonë parasysh që ato të jenë në funksion të realizimit sa më praktik dhe funksional të procesit të shpërndarjes së këtyre produkteve nëpër çerdhet dhe kopshtet e Tiranës, si dhe në funksion të procesit të magazinimit. Përshkrimi i produkteve të kërkuara është bërë në mënyrë të detajuar duke përcaktuar në mënyrë të qartë produktin e kërkuar nga ana cilësore dhe sasiore, duke mos krijuar konfuzion mbi produktet e kërkuara.

Në lidhje me treguesit e përcaktuar në specififikimet e kërkuar për secilin produkt, kryesisht ato solucionet, është e nevojshme të sqarojme se;

- Matja e densitetit është një parametër i rëndësishëm i cilësisë për produktet e pa përpunuara dhe të përfunduara në forma të ngurta dhe të lëngëta dhe kryhet me teknika të ndryshme. Matja e dendësisë, e cila është veçanërisht e rëndësishme në përcaktimin e pastërtisë së materialeve para përpunimit, është e rëndësishme për të përcaktuar nëse një material i huaj është i përzier me lëndën e parë. Nga ana tjetër ky tregues është në funksion të përcaktimit homogjenitetit të produktit.

- Treguesi i Ph (përmbajtja e joneve H⁺) tek solucionet e lëngshme dhe sapunët është shumë e rëndësishme për të përcaktuar neutralitetin (as acid dhe as bazik), sepse në të dy rastet ndikon negativisht në shëndetin e fëmijëve. Ndërsa në rastin e detergjentëve dhe solucionëve për pastrimin e sipërfaqeve të ndryshme, dezinfektant dhe higjenzues, kërkohet me Ph më të lartë duke kaluar në bazë për arsye të ndikimit në emulsionet shkumuese.

- Tretshmëria e substancave në ujë është një nga kushtet kryesore që ndikon në formimin e përbërjes. Sa më e lartë të jetë tretshmëria, aq më të pastra janë produktet.

- Treguesi i lagështirës është shumë i rëndësishëm pasi lagështia ndikon negativisht në jetëgjatësinë e produktit (shpërbën substancat).

- Substancat teknsioaktive-substancat organike ose përzierjet që janë lëndë përbërese të detergjentëve, që veprojnë në sipërfaqe dhe përbëhen nga një ose më shumë grupe hidrofile dhe hidrofobe dhe që kanë aftësinë të zvogëlojnë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojnë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër duke formuar emulsion ose mikroemulsione ose mishela që thithen në kontakt me ujin dhe sipërfaqet e ngurta.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.